



## Lajme > Ekonomi

FSHZH, prioritet rrugët rurale në vend



Shqipëria po punon fort, për të pasur rrjetin rrugor më të ri dhe modern në të gjithë rajonin. Jo vetëm autostradat, apo akset kombëtare por edhe rrugët rurale janë në prioritet të këtij zhvillimi. Në këtë kuadër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, një agjenci shtetërore, po zbaton aktualisht, 25 projekte për ndërtim rrugësh dytësore apo lokale në të gjithë vendin, me prioritet zonat turistike dhe ato me impaktin më të madh për rajonin. Drejtori i fondit, Benet Beci thotë se po zbatohen standartet më të mira europiane. **Benet Beci “Aktualisht po punojmë në 25 segmente me vlerë 80 milionë dollarë”** Një prej projekteve në zbatim e sipër është ndërtimi i rrugës Ura e Farkës-Baldushk në Tiranë, me një gjatësi prej rreth 15 kilometrash. Rrugë të tilla pritet të japin një impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomiko-social të zonës dhe të banorëve. Në total Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka në plan të përmirësojë infrastrukturën rrugore për 1500 kilometra në të gjithë territorin dhe për këtë po angazhohen fonde nga donatorët, mes të cilëve Banka Botërore dhe BERZH, fond që shkon në 400 milionë dollarë